



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE

Nr. 237/1 Prot.

Tiranë, më 27.03.2015

**VENDIM**  
“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 13, datë 27/03 2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**V Ë R E N:**

Ankuesi/z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 237 Prot., datë 23.03.2015, ndaj Autoritetit Publik/Nën/Prefektura Kavajë, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Z. \_\_\_\_\_ në datë 25.11.2014 ka paraqitur pranë autoritetit publik/Nën/Prefektura Kavajë, kërkesën për informacion. Kërkuesi ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht, *Informacion mbi gjurmët e pasurisë në pronësi të Z. \_\_\_\_\_ dhe Z. \_\_\_\_\_ (Të dhëna për pasurinë, harta, transaksione etj.).*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje pavarësisht se ka kaluar afati ligjor. Për këtë arsye ka depozituar ankim në zyrën e Komisionerit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri ka konstatuar se, ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, fakt i cili bie në kundërshtim me nenin 24/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

**V E N D O S A:**

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr. 237 Prot., datë 23.03.2015 të z. \_\_\_\_\_ kundër Autoritetit Publik/Nën/Prefektura Kavajë.

Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 27.03.2015.

